

Ekskluzive

Ekskluzive | Tentim vrasje në Gadime të Lipjanit – breshëri plumbash ndaj një BMW-je, një i arrestuar



Foto ilustruese



Sinjali.com

05 Gusht 2026 09:22



Një ngjarje e rëndë ka tronditur pasditen e së martës fshatin Gadime e Ulët të Lipjanit, ku një konflikt mes dy personave dyshohet se eskaloi në tentim vrasjeje, pasi njëri prej tyre hapi zjarr në drejtim të një veture në lëvizje.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Flamur Ibrahim**i, rreth 41-vjeçar, ndërsa viktimë e rastit E.H., rreth 33-vjeçar.

Sipas burimeve të Sinjalit, ngjarja ka ndodhur rreth orës 17:35, kur viktimja po lëvizte me një BMW me targa gjermane në drejtimin Gadime e Epërme – Gadime e Ulët. Në afërsi të shkollës së mesme, rruga i është bllokuar nga një veturë Audi me ngjyrë hiri.

Nga automjeti, sipas kallëzimit të viktimës, ka zbritur Flamur Ibrahim, i cili fillimisht ka tentuar ta sulmojë fizikisht. Më pas, derisa viktimja ishte larguar me veturë, i dyshuari dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të BMW-së, ku njëra prej predhave ka goditur automjetin në anën e djathtë, mbi derën e pasagjerit.

Pas marrjes së informacionit, në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet policore dhe hetuesit rajonalë të krimeve të rënda, të cilët kanë kryer ekzaminimet e nevojshme. Arma që dyshohet se është përdorur në incident është sekuestruar, ndërsa palët janë intervistuar.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, Flamur Ibrahim është ndaluar për 48 orë, nën dyshimin për veprat penale “Vrasje në tentativë” dhe “Përdorim i armës”.

Hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të rastit janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuat në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

arrestohet nje person

BMW

BRESHËRI PLUMBASH

ekskluzive

Gadime

Lipjan

sinjalizime


Tentim vrasje

Të tjera:



Ekskluzive | “BMW”-ja më ndoqi nga fshati deri në Komoran, më gjuajti të më vras – 19-vjeçari...

Siguri



Ekskluzive | Armë me 5 fishekë nën ulësen e BMW-së – 26-vjeçari ndalohet nga Policia n...

Ekskluzive



Ekskluzive | “Fantazma” e veturave në Prishtinë? Dyshohet për 113 vjedhje – kapet pasi mori 8 mij...

Ekskluzive



Lirohet “Papi Chulo”, shoferi që kishte 225 gjoba për shkelje në trafik

Siguri



Policia kap shoferin e “BMW-së” që shqetësonte qytetarët

Siguri



Shqiptari kapet me BMW-në luksoze, ishte vjedhur gjashtë vite më parë

Diasporë



Shoferi humb kontrollin, përfundon me veturë në një barnatore në Rahovec

Siguri



43 vite pa dalë nga garazhi, BMW-ja e rrallë del në ankand

Automjete

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera